



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ prot.
më _____.____.2019

Elbasan,

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Për: “**Albtelecom**” sh.a me adrese: Kashar, Autostrada Tirane - Durres, km.7
,Tirane.

Lloji i procedurës së prokurimit: Proçedure e Hapur – Marrëveshje Kuadër.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Internet falas per banoret e te gjitha Njesive Administrative dhe qendren e qytetit te Elbasanit” - **Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj. Fondi limit (n.q.s. ka lote i ndarë sipas loteve): 20.600.000(njzet milion e gjashtëqind mije) lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për tre vite financim (2019-2021) , **Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-01944-12-26-2018

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme X çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Albtelecom” sh.a. me Nipt: J 61824053 N

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **18.900.000** (tetembedhjetë milion e nenteqind mije) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **22.680.000** (njzet e dymilion e gjashtëqind e tetedhjetë mijë) **lekë** (me tvsh).

2. "Abissnet" sh.a. me Nipt: K 01417001 C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **12.240.000** (dymbëdhjetemilion e dyqind e dyzetmije) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **14.688.000** (katëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tete mijë) **lekë** (me tvsh).

3. "Abcom" sh.a. me Nipt: K 11308001 B

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **0** (zero) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **0** (zero) **lekë** (me tvsh).

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. "Abissnet" sh.a. me Nipt: K 01417001 C

2. "Abcom" sh.a. me Nipt: K 11308001 B

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. "Abissnet" sh.a. me Nipt: K 01417001 C skualifikohet për arsyet e mëposhtme:

1. Në përmbushje të pikës 2.3.2 të Kapacitetit Teknik të DST : "Operatori ekonomik duhet të paraqesë zgjidhjen teknike dhe bllok-skemën totale të sistemit për zgjidhjen e ofruar për të gjithë teknologjitë që ai do të përdorë . Për këto teknologji, operatori ekonomik duhet të paraqesë licencat përkatëse të leshuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare." Zgjidhja teknike e paraqitur nga ana e OE, ka dy seksione në anglisht duke lënë paqartësi për AK mbi mënyrën e funksionimit të këtij shërbimi. "Bazuar në seksionin 4 të DST, specifikisht pika 4.6 , gjuha e përzgjedhur për hartimin e dokumentave të tenderit është shqipja, prandaj çdo dokumentacion i paraqitur nga OE duhet të jetë në përputhje me gjuhën e zgjedhur, ose në gjuhë të huaj , i përkthyer dhe i noterizuar sipas legjislacionit në fuqi."

2. Në lidhje me pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik të DST : "Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin tekniko-profesional të paktën 8 (tetë) inxhinierë të certifikuar si më poshtë ;
-3(tre) inxhinierë të certifikuar CCNA Routing & Switching ose ekuivalente
-2(dy) inxhinierë të certifikuar CCNA Security ose ekuivalente
-2(dy) inxhinierë të certifikuar CCNP Routing & Switching ose ekuivalente
-1(një) inxhinier i certifikuar Project Manager Profesional (PMP) ose ekuivalente

Për këta 8 inxhinierë operatori ekonomik duhet të paraqesë ;

- Certifikatat përkatëse të kualifikimit
- Të jenë në listepagesat E-SIG të kërkuara për muajin nëntor 2018
- Diplomen e studimeve universitare në këtë fushë (elektronike /telekomunikacion /informatike,Teknologji Informacioni) ;

Operatori Ekonomik ka paraqitur dokumentacion të saktë për inxhinierët e mëposhtëm:

1. A.H. , i certifikuar me CCNA Routing and Switching e përkthyer në gjuhën shqipe si dhe diplome inxhinierie telekomunikacioni.

2.M.K. , i certifikuar me CCNA Routing and Switching e përkthyer në gjuhën shqipe si dhe diplome informatike.

Gjithashtu, OE ka paraqitur dokumentacion për stafin jo të përmbushje të pikës së mësipërme të kapacitetit teknik, konkretisht si mëposhtë:

1. Per personin E.J. çertifikate CCNA Routing and Switching ne anglisht, te paperkthyer ne gjuhen shqipe, çertifikate CCNT Routing and Switching ne anglisht, te paperkthyer ne gjuhen shqipe. 2. Per personin A.B. çertifikate Cybersecurity Course ne anglisht, te paperkthyer ne gjuhen shqipe. 3. Per personin Z.H Diplome Inxhinier Elektrik, drejtimi Energjitike si dhe nuk ka asnje çertifikim. 4. Per personin I.B. Diplome Inxhinier Elektrik drejtimi Automatizim Industrie si dhe nuk ka asnje çertifikim. 5. Per personin D.B. çertifikim nga IRISOFT per implementimin e lidhjeve kabllore. 6. Per personin I.K. çertifikim nga IRISOFT per implementimin e lidhjeve kabllore. 7. Per personin T.G. çertifikim te formimit profesional te specialitetit "Teknik Informatike me Multimedia". 8. Per personin S.H. diplome profesionale per Informatike, profili specialist rrjetesh kompjuterike, si dhe nuk ka asnje çertifikim. Gjithashtu, referuar listepagesave te shoqerise ABISSNET te praqitura ne SPE per muajin nentor 2018, si dhe bazuar VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR" rezultojne se:

1. Per personat E.J. dhe A.B. me kod 3511.03 figurojne te jene OPERATORE KOMPJUTERI.

2. Per personin TH.K. nuk figuron fare ne listepagesa.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : "[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]" "Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji."

"Bazuar ne seksionin 4 te DST, specifikisht pika 4.6 , gjuha e perzgjedhur per hartimin e dokumentave te tenderit eshte shqipja, prandaj cdo dokumentacion i paraqitur nga OE duhet te jete ne perputhje me gjuhen e zgjedhur, ose ne gjuhe te huaj , i perkthyer dhe i noterizuar sipas legjislacionit ne fuqi."

3. Oferta Ekonomike e paraqitur nga ana e operatorit konsiderohet e pavlefshme pasi OE nuk ka respektuar preventivin e ngarkuar ne DST, sipas shtojces 11 nga ana e AK, duke ofertuar me nje çmim ne total dhe jo ne perputhje me zerat e preventivit te ngarkuar.

Bazuar VKM nr 914, date 29.12.2014 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik,i ndryshuar neni 17, "Oferta ekonomike përmban vlerën e ofertës. Kësaj oferte i bashkëlidhet

një listë e hollësishme çmimesh". Kjo liste e detajuar mungon. “ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

2. “Abcom” sh.a. me Nipt: K 11308001 B skualifikohet per arsyet e meposhtme: Operatori ekonomik nuk ka paraqitur oferte ekonomike si dhe dokumentacion ligjor , ekonomik-financiar dhe teknik ne permbushje te kriterëve te DST-se.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:


1. “Albtelecom” sh.a. me Nipt: J 61824053 N

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **18.900.000** (tetembedhjetë milion e nenteqind mijë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **22.680.000** (njetzet e dymilion e gjashtëqind e tetedhjetë mijë) **lekë** (me tvsh).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Bashkise Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.02.2019

Ankesa: nuk ka pasur



TITULLARI I AUTORITETIT

KONTRAKTOR

**PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI**

Klaudia Krasnika